

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Brian Hickerson thyen heshtjen për vdekjen e Hayden Panettiere! “Policia e publikoi...” Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/brian-hickerson-thyen-heshtjen-per-vdekjen-e-hayden-pane-ttiere-policia-e-publikoi/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:48:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:41:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ed7bdf79f659095008fb91a95ffcd3c301b85f061593b30e24878a20e8a45e
TEKSTI	7ea87aea2078d191f7f5e1ae35ed651912025455dd674cfce476a69eb9d34e1f
PAMJA	0eff170e7723c2b8f2291f9252cfa66e09021a4dcb94739399be7161b645cbcd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	47a401194e9e16818428d127bd03c3b6ebd44731127f2de4ef4f4829330aed11
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/47a401194e9e16818428d127bd03c3b6ebd44731127f2de4ef4f4829330aed11>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Brian Hickerson thyen heshtjen për vdekjen e Hayden Panettiere! “Policia e publikoi...”



Redaksia K

17 Shtator 2026



Një muaj pas vdekjes së papritur të aktores **Hayden Panettiere**, ish-partneri i saj, Brian Hickerson, ka folur publikisht për herë të parë, duke iu referuar edhe mënyrës se si është trajtuar rasti nga autoritetet.

Hickerson u shfaq në publik më 16 shtator, saktësisht një muaj **pas vdekjes së Panettiere**, e cila u gjet pa ndjenja në një banesë në Greenville, South Carolina, më 16 gusht, në moshën 36-vjeçare. Sipas raportimeve, Brian dhe vëllai i tij, Zach, ndodheshin në banesë në momentin kur aktorja u gjet e pavetëdijshme.

Në një moment të tensionuar me policinë, Hickerson iu referua drejtpërdrejt vdekjes së ish-partneres së tij dhe pretendoi se informacionet nga rasti ishin bërë publike nga policia.



GPD e publikoi kur e dashura ime vdiq

-tha ai, duke iu referuar Departamentit të Policisë së Greenville.

Komentet e tij vijnë në një periudhë kur hetimi për vdekjen e **Panettiere** vazhdon. Autoritetet ende nuk kanë publikuar shkaktues dhe mënyrën zyrtare të vdekjes, pasi rezultatet toksikologjike nuk janë bërë publike. Zyra e mjekut ligjor të Greenville County ka konfirmuar se hetimi mbetet aktiv.

Panettiere u gjet në arrest kardial dhe ekipet e emergjencës tentuan ta rikthenin. Raportet fillestare të policisë dhe mjekut ligjor nuk kanë evidentuar shenja të dukshme traume apo të dhunës fizike. Megjithatë, autoritetet po hetojnë ende rrethanat e plota të vdekjes.

Hetimi ka marrë gjithashtu një dimension federal. Administrata Amerikane për Luftën kundër

Drogës, DEA, është përfshirë në rast dhe, sipas burimeve të cituara nga PEOPLE, Hickerson është takuar me zyrtarë federalë si pjesë e hetimit.

Burime kanë thënë se autoritetet po shqyrtojnë edhe mundësinë që një person tjetër t'i ketë shitur Panettiere drogë para vdekjes së saj. Këto janë ende pista hetimore dhe nuk përbëjnë një përfundim zyrtar për shkakun e vdekjes.

Brian Hickerson ka qenë në një marrëdhënie të ndërlikuar me **Panettiere** për vite me radhë. Historia e tyre është shoqëruar edhe me probleme ligjore: në vitin 2021, Hickerson u deklarua “no contest” për dy akuza penale për dhunë ndaj një partnerje. Kjo histori është rikthyer në vëmendje pas vdekjes së aktores, por nuk ka prova publike që e lidhin atë si shkaktar të vdekjes së saj.

Në fakt, avokati i Hickerson kishte bërë edhe një deklaratë të mëparshme, vetëm pak ditë pas vdekjes së Panettiere, duke theksuar se hetimi ishte ende në zhvillim dhe se policia kishte konfirmuar se nuk kishte shenja të një krimi të dhunshëm.

Ndërkohë, përfaqësuesi i Panettiere ka kërkuar që publiku të presë për rezultatet zyrtare, duke paralajmëruar se raportimet nga burime anonime kanë krijuar versione kontradiktore për atë që mund të ketë ndodhur.

“Përgjigjet që të gjithë po kërkojnë do të vijnë

-thuhej në deklaratën e përfaqësuesit të aktores.

Deri në publikimin e rezultateve toksikologjike dhe përfundimit të hetimit, shkaku zyrtar i vdekjes së Hayden Panettiere mbetet i pakonfirmuar.

Ajo që dihet është se aktorja 36-vjeçare u gjet e pavetëdijshme në Greenville më 16 gusht dhe se Brian Hickerson ishte një prej personave të pranishëm në banesë në momentin kur u thirrën shërbimet e emergjencës.

LAJME TË NGJASHME



Mesazhet e Hayden Panettiere me tregtarin e dyshuar të drogës në qendër të hetimit?

2 MIN



Një pilulë mund t'i ketë marrë jetën Hayden Panettiere? Zbardhen detaje tronditëse?

2 MIN



Partneri i Hayden Panettiere se i dërgoi mesazhe flirtuese një 26-vjeçareje?

1 MIN



Brian Hickerson kërkoj një lidhje të re vetëm disa muaj para vdekjes së Hayden Panettiere?

1 MIN



Nëna e Hayden Panettiere vë në dyshim versionin e Brian Hickerson për orët e fundit të aktores?

1 MIN

MË TË LEXUARAT





Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Majko përlohet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Trupi glykues: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim

EDITORI SUGJERON



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..."/ Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egove të kolegeve të mia..."/ Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!



10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të viçit për proteina me pak yndyrë!



Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesis live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qesharake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës...



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktoni Marketing Frekuencat Aksueshmëria

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.